



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



# **Analiza e tregut të çimentos në Kosovë**

**për vitet 2018/2019 deri me 30.06.2020**

Prishtinë, Shtator 2022

# Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
<b>Analiza e tregut të çimentos në Kosovë për vitin 2018,2019,2020 (deri me 30.06.2020).....</b>	<b>4</b>
1. Përmbledhja e analizës së tregut të çimentos në Kosovë për periudhën 2018-2019- deri më 30.06.2020.....	4
2. Historiku i ndërmarrjes prodhuese Sharr Cem SHPK.....	4
3. Prodhimet e çimentos nga Prodhuesi A .....	4
4. Importi i Çimentos në Kosovë, përqindja e disa ndërmarrjeve të cilat kanë ndikim të ndjeshme në import, për periudhën 2018 – 2019 - 30.06.2020.....	5
4.1.Struktura e Tregut të Çimentos për vitin 2018, tabela Nr.1.....	5
4.2.Sturktura e Tregut të Çimentos për vitin 2019, tabela Nr.2.....	6
4.3.Sturktura e Tregut të Çimentos deri më 30.06.2020, tabela Nr.3.....	6
<b>5. Prodhimi Vendor i Çimentos dhe Importet për vitet 2018/2019/30.06.2021.....</b>	<b>7</b>
5.1. Prodhimi Vendor i Çimentos dhe Importet e paraqitur në tonë për vitet 2018/2019/30.06.2022 tabela Nr.4.....	7
5.2. Pjesëmarrja në përqindje e prodhimit vendor të çimentos dhe importi për vitin 2018 grafikoni Nr.1.....	7
5.3. Pjesëmarrja në përqindje e prodhimit vendor të çimentos dhe importi për vitin 2019 grafikoni Nr.2.....	7
5.4. Pjesëmarrja në përqindje e prodhimit vendor të çimentos dhe importi për vitin 2020 - 30.06.2020, grafikoni Nr.3.....	7
5.5. Qarkullimi vjetor i paraqitur në miliona euro të prodhuesit A dhe 5 importuesit me % më të madhe në importe prej vitet 2018/2019/30.06.2020, tabela Nr.5.....	8
5.6.Qarkullimi vjetor i paraqitur në % për vitin 2018, grafikoni Nr.4.....	8
5.7.Qarkullimi vjetor i paraqitur në % për vitin 2019, grafikoni Nr.5.....	9
5.8.Qarkullimi vjetor i paraqitur në % për vitin 2020 - 30.06.2020, grafikoni Nr.6.....	9
<b>6. Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2018.....</b>	<b>9</b>
6.1. Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2018, tabela Nr.6.....	9
6.2. Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2018, grafikoni Nr.7.....	10
<b>7. Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2019 .....</b>	<b>10</b>
7.1. Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2019, tabele Nr.7.....	10
7.2. Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2019,grafikoni Nr.8.....	10
<b>8. Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit deri më 20.06.2020.....</b>	<b>11</b>
8.1.Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë deri më 30.06.2020,tabele Nr.8.....	11
8.2.Pjesëmarrja e G në Kosovë dhe eksportuesit tjerë deri më 30.06.2020,grafikoni Nr.9.....	11

<b>9. Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitet 2018/2019/2020 - 30.06.2020</b> .....	11
9.1. Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2018, tabela Nr.9.....	11
9.2. Pjesëmarrja e çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2018, grafikoni Nr.10.....	12
9.3. Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2019, tabela Nr.10.....	12
9.4. Pjesëmarrja e çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2019, grafikoni Nr.11.....	12
9.5. Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2020 - 30.06.2020, tabela Nr.11.....	12
9.6. Pjesëmarrja e çimentos nga vendet e rajonit deri më 30.06.2020, grafikoni Nr.12.....	13
<b>10. Krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut</b> .....	13
10.1 Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2018, tabela Nr.12 .....	13
10.2 Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, tabela Nr.13 .....	13
10.3 Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut deri me 30.06.2020, tabela Nr.14 .....	13
<b>11. Klinkeri i importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut</b> .....	13
11.1 Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2018, tabela Nr.15 .....	13
11.2 Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2019, tabela Nr.16 .....	14
11.3 Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2020 - 30.06.2020, tabela Nr.17 .....	14
<b>12. Importi i çimentos për vitin 2018, të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të Madhe në tregun e Kosovës</b> .....	15
<b>13. Importi i çimentos për vitin 2019, të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të Madhe në tregun e Kosovës</b> .....	15
<b>14. Importi i çimentos për vitin 2020 deri më 30.06.2020 të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të madhe në tregun e Kosovës</b> .....	15
<b>15. Konkluzion</b> .....	19

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 28 paragrafi 2, neni 30, neni 38 paragrafi 1, si dhe neni 61 paragrafi 3, ka filluar mbledhjen e të dhënave për tregun e çimentos në Kosovë.

Për ta analizuar tregun e çimentos në Kosovë Autoriteti i Konkurrencës ka mbledhur dhe përpunuar të dhënat e ofruara nga institucione dhe ndërmarrje të ndryshme:

1. Dogana e Kosovës
2. Ndërmarrja prodhuese –( A )
3. Ndërmarrja Importuese –( B )
4. Ndërmarrja Importuese –( C )
5. Ndërmarrja Importuese –( D )
6. Ndërmarrja Importuese –( E )

## **I. Përmbledhja e analizës së tregut të çimentos në Kosovë për periudhën 2018-2019- deri më 30.06.2020**

Autoriteti i Konkurrencës në këtë analizë të tregut të çimentos në Kosovë paraqet: **strukturën e tregut, pjesëmarrësit në tregun përkatës, sjelljen e tyre, përparësitë ose dobësitë, nivelin e konkurrencës në këtë treg.** Gjithashtu në këtë analizë paraqitet **prodhimi vendor të çimentos, importin e kompanive kryesore që afrojnë në këtë treg, pjesëmarrjen e tyre në tregun e Kosovës, krahasimin e çmimeve me tregjet rajonale (Shqipëri, Maqedoni e Veriut në raport me prodhimin vendor), për periudhën 2018-2020 - 30.06.2020.**

Kjo analizë e tregut do të publikohet në web faqen e AKK-së duke u bazuar në nenin 50 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## **II. Historiku i ndërmarrjes prodhuese Sharr Cem SHPK**

Në fillim të vitit 2010 Titan Group kishte marrë përsipër operimin e fabrikës së çimentos “Sharr” në atë kohë ishte në pronësi dhe pjesë e Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr” (**Fabrika e Çimentos**), pas blerjes së **Sharr Beteiligungs GmbH**, një kompani gjermane, e cila operonte Fabrikën e Çimentos si qiramarrës në bazë të një marrëveshje të qirasë të lidhur në qershor 2000 dhe të paraparë për të qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2010 (“**Marrëveshja e Qirasë**”).

Në fund të vitit 2010 pasuritë/asetet e Fabrikës së Çimentos u transferuan në një kompani të themeluar rishtas, “Ndërmarrja e Re Sharr Cem ShP.K” aksionet e së cilës ishin ofruar për shitje në procesin e privatizimit. Pas fillimit të procesit të privatizimit, Sharr Beteiligungs GmbH ushtroi të drejtat e veta të parablerjes sipas Marrëveshjes së Qirasë, sipas së cilës qiramarrësi gëzonte *të drejtën e refuzimit (ofertimit) të parë* në rast se Fabrika e Çimentos ofrohej për shitje. Pas përfundimit të procedurës së privatizimit, më 9 dhjetor 2010 Sharr Beteiligungs GmbH bleu/fitoi 100% të aksioneve të “Ndërmarrja e Re Sharr Cem” ShPK” që më pas u riemërua **kompania Sharr Cem ShPK.**

## Prodhimet e çimentos nga Kompania –( A)

Prodhimet e ngjashme të çimentos janë përdorur për ndërtimet greke dhe ato romake para më shumë se 2000 vjet, megjithatë çimentoja bashkëkohore për herë të parë ishte prodhuar në gjysmën e parë të shekullit nëntëmbëdhjetë.

Çimentoja është lëndë e parë që përdoret për prodhimin e betonit si edhe të prodhimeve të tjera ndërtimore të cilat kanë dedikim të ndryshëm. Çimentoja, si material pluhur lidhëse është pjesë e grupit të agjendave joorganike hidraulike lidhëse.

Agjentët hidraulike lidhëse bëhen të forta në praninë të ujit prej të cilit fitohen prodhime të kristalizuara të cilat nuk shkrihen në ujë. Për shkak se agjentët hidraulike lidhëse bëhen të forta në ujë, d.m.th. nuk ndryshohen në ekspozimin permanent të ujit.

Çimentoja është një nga materialet më të rëndësishme dhe më të shfrytëzuara në ndërtimtari. Para se të forcohet fort lidhet me mineralët dhe agregatet e tjera, çelik, tulla, me çfarë mundësohet përdorimi i gjerë në dizajnin e ndërtimeve nga betoni i zakonshëm, betoni i forcuar dhe betoni i para shtrënguar, muret e tullave dhe gurëve natyror, si edhe në dizajnin e mbështjelljeve të brendshme dhe të jashtme prej llaçit etj.

Fabrika e prodhimit të çimentos( A) momentalisht prodhon tri lloje të çimentos Portland, lidhës hidraulik, dhe Usjemall: - CEM II/A-V 42,5 R\*), MKS; CEM II/B-M (V-L) 42,5 N  
-CEM II/B-M (V-L) 42,5 N, MKS; CEM II/A-V 42,5 R  
-CEM I 42,5 R MKS; CEM I 42,5 R  
-Usjemall (lidhësi hidraulik) \*) 45S – një klasë çimentoje me rezistencë të zakonshme në shtypje të hershme (në 3 ditë) të treguar nga( C).

Çimentoja e përhimët “Portland” është material lidhës e cila përdoret në të gjitha sferat të ndërtimtarisë për ndërtimin e shtëpive, banesave, shkollave, spitaleve, tuneleve dhe aeroporteve.

Çimentoja e përhimët “Portland” është lloj i çimentos që bëhet nga klinkeri i bluar, gips dhe pozollanë natyrore (lënda e parë që fitohet nga shkëmbat vullkanik) dhe hiri i qymyrit. Klientët i përdorin këto lloje të çimentos për çdo punë ndërtimore, megjithatë, përdorimi kryesor e kanë për projektet ndërtimore të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm me ujë ose të cilat ndërtohen në tokë të lagët.

### III. Importi i Çimentos në Kosovë, përqindja e disa ndërmarrjeve të cilat kanë ndikim të ndjeshme në import, për periudhën 2018 – 2019 - 30.06.2020

STURKTURA E TREGUT TË ÇIMENTOS PËR VITIN 2018				
Nr.	Operatorët	Adresa	Pesha neto në tonë	Përqindja
1	B	(.....)	(.....)	(.....)
2	C	(.....)	(.....)	(.....)
3	A	(.....)	(.....)	(.....)
4	E	(.....)	(.....)	(.....)
5	D	Viti	(.....)	(.....)
6	Përafërsisht 55 ndërmarrje tjera	//	168,667.61	20.84%
	<b>Total</b>		<b>809,532.50</b>	<b>100.00%</b>

Tabela Nr. 1

Në tabelën Nr. 1, paraqesim Importin e çimentos për vitin 2018 i cili ishte 809,532.50 tonë, ndërmarrja (B) në importin e përgjithshëm kishte pjesëmarrjeje prej 38.78%, (C) rreth (F) 12.98%, (A) prej 10.41%, (E) prej 8.63, (D) prej 8.36%, ndërsa 55 ndërmarrje tjera prej 20.84%.

<b>STURKTURA E TREGUT TË ÇIMENTOS PËR VITIN 2019</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Operatorët</b>	<b>Adresa</b>	<b>Pesha neto në TONË</b>	<b>Përqindja</b>
1	B	(.....)	(.....)	(.....)
2	C	(.....)	(.....)	(.....)
3	Ç	(.....)	(.....)	(.....)
4	D	(.....)	(.....)	(.....)
5	A	(.....)	(.....)	(.....)
6	Përafërsisht 57 ndërmarrje tjera	/	172,423.32	23.24%
	<b>Total</b>		<b>742,167.55</b>	<b>100.00%</b>

Tabela Nr.2

Në tabelën Nr. 2, paraqesim Importin e çimentos për vitin 2019 i cili ishte 742,167.55 tonë, ndërmarrja (B) në importin e përgjithshëm kishte pjesëmarrjeje prej 36.71%,(C), (F) prej 16.47%, (D) prej 9.06%, (E) prej 7.26, (A) prej 7.26%, ndërsa 57 ndërmarrje tjera prej 23.24%.

<b>STURKTURA E TREGUT TË ÇIMENTOS DERI MË 30.06.2020</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Operatorët</b>	<b>Adresa</b>	<b>Pesha neto në TONË</b>	<b>Përqindja</b>
1	B	(.....)	(.....)	(.....)
2	C	(.....)	(.....)	(.....)
3	E	(.....)	(.....)	(.....)
4	D	(.....)	(.....)	(.....)
5	A	(.....)	(.....)	(.....)
6	Përafërsisht 58 ndërmarrje tjera		66,329.98	25.79%
	<b>Total</b>		<b>257,236.00</b>	<b>100.00%</b>

Tabela Nr. 3


Në tabelën Nr. 3, paraqesim Importin e çimentos për vitin 2020 -(30.06.2020) i cili ishte 257,236.00 tonë, ndërmarrja (B) në importin e përgjithshëm kishte pjesëmarrjeje prej 42.36%, (C) ,(F) prej 14.40%,(E) prej 7.87, (D) prej 5.86%, (A) prej 3.72%, ndërsa 58 ndërmarrje tjera prej 25.79%.

#### **IV. PRODHIMI VENDOR I ÇIMENTOS DHE IMPORTET PËR VITET 2018/2019/30.06.2021**

<b>Prodhimi Vendor i Çimentos dhe Importet e paraqitur në tonë për vitet 2018/2019/30.06.2020</b>							
<b>Nr.</b>	<b>Ndërmarrja</b>	<b>2018</b>	<b>%</b>	<b>2019</b>	<b>%</b>	<b>Deri me 30.06.2020</b>	<b>%</b>
1	A	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)
2	Importi	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)
	<b>Gjithsejtë</b>	<b>1568.53</b>	<b>100.00</b>	<b>1452.17</b>	<b>100.00</b>	<b>561.24</b>	<b>100.00</b>


Tabela Nr.4

**Pjesëmarrja në përqindje e prodhimit vendor të çimentos dhe importi për vitin 2018**




*Grafikoni Nr.1*

**Pjesëmarrja në përqindje e prodhimit vendor të çimentos dhe importi për vitin 2019**



*Grafikoni Nr.2*

**Pjesëmarrja në përqindje e prodhimit vendor të çimentos dhe importi për vitin 2020 - 30.06.2020**



*Grafikoni Nr.3*

Në tabelën Nr. 4 është krahasuar prodhimi vendor dhe importet për periudhën 2018/2019/20.06.2020:

- **Për vitin 2018 nga prodhimi (.....) i çimentos plotësoheshin nevojat prej 48.39% të tregut, kurse nga importi prej 51.61 %.**
- **Për vitin 2019 prodhimi prej 48.89 %, (.....) prej 51.11%.**
- **Për vitin 2020 - 30.06.2020 prodhimi prej 54.17 %, (.....) prej 45.83%.**

Kur analizojmë vitet 2018-2019-30.06.2020 vërehet se në vitin 2018 dhe 2019 prodhimi vendor kishte qenë më i ulët se sa importi, kurse në vitin 2020 deri më 30.06.2020, prodhimi vendor kishte mbuluar nevojat e tregut rreth (.....) ndërsa importi rreth (.....).

**Qarkullimi vjetor i paraqitur në miliona euro të prodhuesit (A) dhe 5 importuesit me % më të madhe në importe prej vitet 2018/2019/30.06.2020**

Nr.	Ndërmarrja	2018	%	2019	%	Deri më 30.06.2020	%
1	A	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)
2	D	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)
3	B	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)
4	E	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)
5	C	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)	(.....)
	Gjithsejtë:	<b>81.21</b>	<b>100.00</b>	<b>90.11</b>	<b>100.00</b>	<b>38.26</b>	<b>100.00</b>


Tabela Nr.5

Në tabelën Nr. 5 paraqitet qarkullimit vjetor i ndërmarrjeve (.....) dhe (.....) për vitin 2018, ndërmarrja (.....) -(A) kishte 48,39 %, të tregut, ndërmarrjet (.....) -(D) 16.01%, (B) 15.59%, (E) 12.22% dhe ndërmarrja (C) 7.97%.

Në vitin 2019, ndërmarrja prodhuese (A) kishte 46.61%, të tregut, ndërmarrjet (.....): (E) 16.01%,(B) 14.54%, (D) 13.32% dhe (C) 9.52% ndërsa:


Për vitin 2020 deri më 30.06.2020 ndërmarrja (.....) (A) kishte 52.27%, të tregut, ndërmarrjet (.....): (B) 15.76%, (E) 12.76%, (D) 10.45%, dhe (C) 8.73 %.

**Qarkullimi vjetor i paraqitur në % për vitin 2018**




Grafikoni Nr.4

**Qarkullimi vjetor i paraqitur në % për vitin 2019**





## Qarkullimi vjetor i paraqitur në % për vitin 2020 - 30.06.2020




Grafikoni Nr.6

## I. Pjesëmarrja e Titan Group në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2018

Emrat e kompanive prodhuese/eksportuese vendi i origjinës	Importi/prodhimi në tonë	2018	%
Prodhimi i ndërmarrjes (A) Kosovë	(.....)	1,208,802.31	77.07
I	(.....)		
J	(.....)		
K	(.....)		
H	(.....)	315,051.64	20.08
Importet nga fabrikat tjera	(.....)	44,678.56	2.85
<b>Gjithsejtë importi dhe prodhimi vendor</b>	<b>1,568,532.51</b>	<b>1,568,532.51</b>	<b>100.00</b>

Tabela Nr.6

Në tabelën Nr. 6, Autoriteti, ka nxjerr pjesëmarrjen e (G) në Kosovë, si dhe eksportuesit nga fabrikat e tjera për vitin 2018, nga kjo analizë vërehet se (G) së bashku me fabrikën e çimentos në Kosovë (A), të (.....), (.....) së (.....) dhe (.....) kishte mbuluar nevojat e tregut të çimentos në (.....) prej 77.07%, Fabrika (H), (.....) merr prej 20.08% ndërsa nga fabrikat tjera të rajonit prej 2.85%.



Grafikoni Nr.7

## II. Pjesëmarrja e (G) në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2019

Emrat e kompanive prodhuese/eksportuese vendi i origjinës	Importi/prodhimi në tonë	Gjithsejtë	%
Prodhimi i ndërmarrjes (A) - Kosovë	(.....)	1,128,227.70	77.69
(G)	(.....)		
(J)	(.....)		
(K)	(.....)		
(H)	(.....)	272,741.30	18.78
Importet nga fabrikat tjera	(.....)	19,852.26	3.53%
<b>Gjithsejtë importi dhe prodhimi vendor</b>	<b>1,452,167.55</b>	<b>1,452,167.55</b>	<b>100.00</b>

Tabela Nr.7

Nga tabela Nr. 7, Autoriteti, ka nxjerr pjesëmarrjen e (G) në Kosovë, si dhe eksportuesit nga fabrikat e tjera për vitin 2019, nga kjo analizë (G) së bashku me fabrikën e çimentos në Kosovë (A), (.....), (.....) së (.....) dhe (.....) kishte mbuluar nevojat e tregut të çimentos në Kosovës prej 77.69%, Fabrika (H), merr pjesë prej 18.79 % ndërsa nga fabrikat e tjera prej 3.53%.




Grafikoni Nr.8

## III. Pjesëmarrja e (G) në Kosovë, si dhe eksportuesit nga fabrikat e tjera për vitin 2020 deri më 30.06.2020

Emrat e kompanive prodhuese/eksportuese vendi i origjinës	Importi/prodhimi në tonë	30.06.2020	%
Prodhimi i ndërmarrjes (A) - Kosovë	(.....)	433,341.80	77.21
(I)	(.....)		
(J)	(.....)		
(K)	(.....)		
(H)	(.....)	108,971.68	19.42
Importet nga fabrikat tjera dhe rajonit	(.....)	18,922.52	3.37
<b>Gjithsejtë importi dhe prodhimi</b>	<b>561,236.00</b>	<b>561,236.00</b>	<b>100.00</b>

Tabela Nr.8

Nga tabela Nr. 8, Autoriteti, ka nxjerr pjesëmarrjen e (G) në Kosovë, si dhe eksportuesit nga fabrikat e tjera për vitin 2020 deri më 30.06.2020, nga kjo analizë (G) së bashku me fabrikën e çimentos në Kosovë (A), (.....), (.....) së (.....) dhe (.....) kishte mbuluar nevojat e tregut të çimentos në (.....) prej 77.21%, Fabrika (H), e cila nuk është pjesë e (.....) merr pjesë prej 19.42 % ndërsa nga fabrikat e tjera prej 3.37%.




Grafikoni Nr.9

**IV. Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitet 2018/2019/2020 - 30.06.2020**

Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2018			
Nr.	Vendi	Pesha Neto	%
1	Shqipëria	(.....)	(.....)
2	Maqedonia e veriut	(.....)	(.....)
3	Greqia	(.....)	(.....)
4	Vendet tjera	9,079.71	1.12
<b>Gjithsejtë</b>		<b>809,529.08</b>	<b>100.00</b>

Tabela Nr.9


Në tabelën Nr. 9, Autoriteti, ka paraqitur analizën e importit të çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2018, 55,35% ishte importuar nga (.....), (.....) 43,26%, (.....) 0,27% si dhe nga vendet tjera 1,12%.



Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2019			
Nr.	Vendi	Pesha Neto	%
1	Shqipëria	(.....)	(.....)
2	Maqedonia e veriut	(.....)	(.....)
3	Greqia	(.....)	(.....)
4	Vendet tjera	6,219.41	0.84
	<b>Gjithsejtë</b>	<b>742,167.55</b>	<b>100.00</b>

Tabela Nr.10

Në tabelën Nr. 10, Autoriteti, ka paraqitur analizën e importit të çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2019, 53,03% ishte importuar nga (.....), (.....) 46,04%, (.....) 0,09% si dhe nga vendet tjera 0.84%.




Grafikoni Nr.11

Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2020 - 30.06.2020			
Nr.	Vendi	Pesha Neto	%
1	Shqipëria	(.....)	(.....)
2	Maqedonia e veriut	(.....)	(.....)
3	Greqia	(.....)	(.....)
4	Vendet tjera	2,823.62	1.10
	<b>Gjithsejtë</b>	<b>257,236.00</b>	<b>100.00</b>

Tabela Nr.11

Në tabelën Nr. 11, Autoriteti, ka paraqitur analizën e importit të çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2020 deri më 30.06.2020, 61,09% ishte importuar nga (.....), (.....) 37,71%, (.....) 0,10% si dhe nga vendet tjera 1.10%.

Pjesëmarrja e çimentos nga vendet e rajonit për vitin  
2020 - 30.06.2020



Grafikoni Nr.12

Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2018				
Kodi tarifor	Përshkrimi tarifor	Shqipëria	Maqedonia e Veriut	%
2523900000	Çimento të tjera hidraulike	(.....)	(.....)	
2523290000	Çimento Portland, jo e bardhë	(.....)	(.....)	4.31
2523100000	Klinker prej çimentos	(.....)	(.....)	-79.94

Tabela Nr.12

Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2019				
Kodi tarifor	Përshkrimi tarifor	Shqipëria	Maqedonia e veriut	%
2523900000	Çimento të tjera hidraulike	(.....)	(.....)	
2523290000	Çimento Portland, jo e bardhë	(.....)	(.....)	7.39
2523100000	Klinker prej çimentos	(.....)	(.....)	- 72.51

Tabela Nr.13

Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut deri me 30.06.2020				
Kodi tarifor	Përshkrimi tarifor	Shqipëria	Maqedonia e veriut	%
2523900000	Çimento të tjera hidraulike	(.....)	(.....)	
2523290000	Çimento Portland, jo e bardhë	(.....)	(.....)	5.12
2523100000	Klinker prej çimentos	(.....)	(.....)	-42.42

Tabela Nr.14

Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2018			
Nr.	Shteti	Pesha neto në tone	%
1	Shqipëria	(.....)	2.92
2	Maqedonia e Veriut	(.....)	7.22
3	<b>Gjithsejtë importi i klinkerit</b>	<b>82,072,780</b>	<b>10.14</b>

Tabela Nr.15

**Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2019**

Nr.	Shteti	Pesha neto	%
1	Shqipëria	(.....)	0.17
2	Maqedonia e Veriut	(.....)	7.01
3	<b>Gjithsejtë importi i klinkerit</b>	<b>53,247,980</b>	<b>7.18</b>

Tabela Nr.16

**Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2020 - 30.06.2020**

Nr.	Shteti	Pesha në tonë	%
1	Shqipëria	(.....)	0.20
2	Maqedonia e Veriut	(.....)	3.41
3	<b>Gjithsejtë importi i klinkerit</b>	<b>9,290,380</b>	<b>3.61</b>

Tabela Nr.17

Analiza e tregut për produktet e importuara të çimentos me kodin tarifor 2523900000 Çimento të tjera hidraulike, kodin tarifor 2523290000 Çimento Portland, jo e bardhë dhe kodin tarifor 2523100000, Klinker prej çimentos, është analizuar me qëllim për të parë strukturën dhe dinamikën e këtij tregu, pengesat dhe përparësitë, çmimet në vendet e rajonit dhe në Kosovë.

Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar prodhimin vendor dhe importin e çimentos në vitin 2018, nga prodhimi vendor ishin plotësuar nevojat rreth 48 %, Importi 52% në vitin 2019, prodhimi rreth 49 %, Importi 51%, në vitin 2020 (30.06.2020) prodhimi rreth 54%, Importi rreth 46%.

Prodhimi vendor kishte pasur rritje në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 rreth 5%, sepse kufiri me Maqedoninë e Veriut ishte ndaluar për shkak të masave e protokolleve për parandalimin e virusit Covid-19.

Për vitin 2018, pjesëmarrja e (G) së bashku me fabrikën e çimentos në (.....) (A), (I) në (.....), (J) (.....) dhe fabrika (K) në (.....), kishte mbuluar nevojat e tregut të Kosovës me çimento rreth 77 %, fabrika e çimentos (H) nga (.....) kishte mbuluar nevojat e tregut e çimento rreth 20 %, ndërsa nga fabrikat tjera të rajonit rreth 3%.

Ndërsa në vitin 2019, pjesëmarrja e (G) së bashku me fabrikën e çimentos në (.....) (A), fabrika (I), (J), (.....) dhe fabrika (K) nga (.....), kishte mbuluar tregun e Kosovës me çimento rreth 78 %, fabrika e çimentos (H) nga Shqipëria kishte mbuluar tregun e çimento rreth 19 %, ndërsa nga fabrikat tjera të rajonit rreth 3%.

Deri më 30.06.2020 pjesëmarrja e (G) së bashku me fabrikën e çimentos në (.....) (A), (I) në (.....), (J), nga (.....) dhe ndërmarrja (K) nga (.....) kishte mbuluar tregun e Kosovës me çimento rreth 77. %, fabrika e çimentos (H) nga Shqipëria kishte mbuluar tregun e çimento rreth 19 %, ndërsa nga fabrikat tjera rreth 4%.

***Importi i çimentos për vitin 2018, të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të madhe në tregun e Kosovës***

1. Ndërmarrja (B)" Shpk, kishte prej 38.78% të importit, e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (H) në Shqipëri.
2. Ndërmarrja (C dhe I) kishte prej 12.98%, të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (N) .
3. Ndërmarrja (A) kishte prej 10.41%, të importit e cila kishte blerë **klinker** në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut dhe (I) në Shqipëri.
4. Ndërmarrja (E) kishte prej 8.63%, të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e (J) në Maqedoninë e Veriut dhe (I) Shqipëri.
5. Ndërmarrja (D) kishte prej 8.36%, të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e (J) në Maqedoninë e Veriut dhe (I) në Shqipëri.
6. Pjesa tjetër e importi të çimentos kishin importuar rreth 55 ndërmarrje tjera, prej 20.84% të importit.

***Importi i çimentos për vitin 2019, të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të madhe në tregun e Kosovës***

1. Ndërmarrja (B) kishte prej 36.71% të importit, e cila kishte blerë çimento në fabrikën e (H) në Shqipëri.
2. Ndërmarrja (C dhe H) kishte prej 16.47% të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut.
3. Ndërmarrja (A) kishte prej 7.26%, të importit e cila kishte blerë klinker në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut dhe (I) në Shqipëri.
4. Ndërmarrja (E) kishte prej 7.26% të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut dhe (I) në Shqipëri.
5. Ndërmarrja (D) kishte prej 9.06% të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut dhe (I) në Shqipëri.
6. Pjesa tjetër e importi të çimentos kishin importuar rreth 55 ndërmarrje tjera, prej 23.24% të importit.

***Importi i çimentos për vitin 2020 deri më 30.06.2020 të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të madhe në tregun e Kosovës***

1. Ndërmarrja (B) kishte prej 42.36% te importit, e cila kishte blerë çimento në fabrikën e (H) në Shqipëri.
  2. Ndërmarrja (C dhe F) kishte prej 14.40%, të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut.
  3. Ndërmarrja (A) kishte prej 3.72%, të importit e cila kishte blerë **klinker** në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut dhe (I) në Shqipëri.
  4. Ndërmarrja (E) kishte prej 7.26% të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut.
  5. Ndërmarrja (D) kishte prej 5.86% të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (J) në Maqedoninë e Veriut.
  6. Pjesa tjetër e importit të çimentos kishin importuar prej 55 ndërmarrje tjera, prej 25.80% të importit.
- Në vitin 2018, pjesëmarrja e importit të çimentos në Kosovë nga Shqipëria ishte 55.35%, nga Maqedonia e Veriut 43.26%, nga Greqia 0,27%, ndërsa nga vendet tjera 1.12%.

Në vitin 2019, pjesëmarrja e importit të çimentos në Kosovë nga Shqipëria ishte 53.03%, nga Maqedonia e veriut 46.04% nga Greqia 0,09% ndërsa nga vendet tjera 0.84%.

Në vitin 2020 deri më 30.06.2020 pjesëmarrja e importit të çimentos në Kosovë nga Shqipëria ishte 61.09%, nga Maqedonia e veriut 37.71%, nga Greqia 0,10% ndërsa nga vendet tjera 1.10.

Autoriteti ka analizuar importin e klinkerit, ndërmarrja (A) kishte importuar klinker nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut:

- Në vitin 2018 nga Shqipëria pjesëmarrja e klinkerit në importin e çimentos ishte 2.92%, ndërsa nga Maqedonia e Veriut 7.22%.
- Në vitin 2019 nga Shqipëria pjesëmarrja e klinkerit në importin e çimentos ishte prej 0.17% nga Maqedonia e veriut 7.01%.
- Në vitin 2020 deri më 30.06.2020 pjesëmarrja e klinkerit në importin e Çimentos ishte prej 0.20% ndërsa nga Maqedonia e Veriut 3.41%.

Çmimet e çimentos për vitin 2018 me përshkrimin tarifor 2523900000 produkti çimento të tjera hidraulike importuar nga (.....), çmimi mesatar pa TVSH ishte rreth 52 euro për tonë, ndërsa nga (.....) dhe (.....) nuk kishte import me këtë përshkrim tarifor.

Çimentoja me përshkrimin tarifor 2523290000 produkti çimento portland jo e bardhë në vitin 2019, çmimi mesatar pa TVSH importuar nga (.....) ishte rreth 59.50 euro për tonë, ndërsa nga (.....) rreth 63.93 euro, nga analiza e çmimeve për këtë vit nga (.....) krahasuar me (.....) kishte pasur ngritje rreth 7.50%.

Çimentoja me përshkrimin tarifor 2523290000 produkti çimento portland jo e bardhë, për vitin 2020 deri më 30.06.2020 çmimi mesatar pa TVSH importuar nga (.....) ishte rreth 65.54 euro për tonë, ndërsa nga (.....) rreth 68.90 euro, çmimi i këtij produkti i importuar nga (.....) krahasuar me (.....) kishte pasur ngritje rreth 5.10%.

Gjatë analizës së çmimeve të ndërmarrjes prodhuese të çimentos (A) në vitin 2018, çmimi mesatar për tonë ishte rreth 55.20 euro, për vitin 2019 rreth 60.90 euro, ndërsa për vitin 2020 deri më 30.06.2020) ishte rreth 67.00 euro. Çmimet e ndërmarrjes (A) kishin pasur rritje për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 rreth 10%, ndërsa për vitin 2020 deri më 30.06.2020 krahasuar me vitin 2019 gjithashtu rreth 10%.

Autoriteti bëri krahasimin e çmimeve të çimentos ndërmjet ndërmarrjes prodhuese (A) , duke e krahasuar me Shqipërinë në vitin 2018, çmimi prodhues krahasuar me Shqipërinë ishte me e lart rreth 6%. në vitin 2019, rreth 2%, gjithashtu edhe për vitin 2020 deri më 30.06.2020 çmimi i prodhimit ishte më i lartë rreth 2%.

Autoritet bëri krahasimin e çmimeve të çimentos ndërmjet ndërmarrjes prodhuese (A) me Maqedoninë e Veriut në vitin 2019 çmimi prodhues krahasuar me Maqedoninë e Veriut ishte me i ulët rreth 5%, gjithashtu edhe për vitin 2020 deri më 30.06.2020 çmimi i prodhimit ishte më i ulët rreth 3%.

Klinkeri me përshkrimin tarifor 2523100000 produkti klinker prej çimentos në vitin 2018 importuar nga Shqipëria, çmimi mesatar pa TVSH ishte rreth 43.90 euro për tonë, ndërsa nga Maqedonia e Veriut rreth



35.10, euro për tonë, çmimi i klinkerit i importuar nga Maqedonia e Veriut ishte me i ulët se sa Shqipëria rreth -80%. Në vitin 2019 nga Shqipëria çmimi mesatar ishte rreth 47.50 euro për tonë, nga Maqedonia e Veriut ishte rreth 34.50 euro për tonë, rreth -72.50% çmimi ma i ulët nga Maqedonia e Veriut se sa Shqipëria. Ndërsa deri më 30.06.2020 nga Shqipëria çmimi ishte rreth 47.60 euro, nga Maqedonia e Veriut ishte rreth 34.50 euro, çmimi nga Maqedonia e veriut ishte me i ulët se në Shqipëri rreth -42%.

Autoriteti gjatë analizës ka vërejtur se: ndërmarrjet e lartë cekura të cilat prodhojnë, blejnë dhe shesin çimento në Kosovë rreth 80% e këtyre ndërmarrjeve kanë kontrata me klientët, në kontrata është e potencuar në rast se ka ngritje apo ulje të çmimeve shitësi njofton blerësin për ndryshimin e çmimeve.

Lidhur me strategjinë e shitjeve kompanitë deklaruan se, me klientët e tyre sillen me korrektësi dhe cilësi të produktit e cila vërtetohet me certifikatë të analizave laboratorike, kompanitë sigurojnë makineri transportuese për transport deri te ndërmarrjet që e kërkojnë produktin, stafi i kompanive analizojnë tregun dhe pas kësaj merren vendimet që janë konformë kërkesave të blerësve, sjellja ndaj klientit ndikon për kryerjen e porosive me kohë të caktuar.

**Sipas deklarimeve të kompanisë prodhuese (A) strategjia primare** dhe kyçe që secili prodhues i çimentos duhet të ndjekë është cilësia e produktit. Ndërmarrja i përmbahet kësaj strategjie edhe kur blejmë fabrika të vjetra, si (A), dhe e bëjmë këtë duke bërë investime të konsiderueshme për të siguruar se produktet e (A) i arrijnë standardet e cilësisë së fabrikave të reja bashkëkohore të çimentos. Duke u fokusuar në cilësi kompania synon klientë të mëdhenj që kanë nevojë për cilësinë. Si rezultat i kësaj strategjie, kompania ka furnizuar dhe vazhdon të furnizoj me çimento disa nga projektet më të mëdha infrastrukturore dhe të ndërtimit në Kosovë përgjatë dhjetë (10) viteve të fundit.

Sipas deklarimeve të ndërmarrjeve në tregun e çimentos në Kosovë konkurrenca është e madhe kompanitë janë të detyruar t'i përshtaten tregut, margjina e shpenzimeve te disa kompani është e vogël. Ka prej kompanive që e kalkulojnë shpenzimet operative dhe më pastaj dalin me çmim në treg.

Fabrika e çimentos (A) faktori themelor në përcaktimin e çmimeve të çimentos në Kosovë, si në çdo ekonomi të lirë të tregut, është marrëdhënia ndërmjet ofertës dhe kërkesës. Industria e çimentos është një sektor me kërkesa të jashtëzakonshme/intensive për kapital, i cili kërkon investim kapital të konsiderueshëm për instalimin dhe operimin e një fabrike të çimentos (në rangun prej 200 – 250 euro për tonë metrik të kapacitetit për projektet në fushën e gjelbër në vendet evropiane). Për më tepër, prodhimi i çimentos është një proces prodhimi me kërkesa të jashtëzakonshme/intensive të energjisë, ku nafta dhe elektriciteti i nevojshëm mund të thithin më shumë se 80% të kostove variable. Çmimet e çimentos varen po ashtu edhe në çmimet e produkteve zëvendësuese të ndërtimit, si çeliku, druri, etj. të cilat përdoren po ashtu në ndërtimin e ndërtesave të banimit, zonat industriale dhe instalimet të tjera.

Çmimet e çimentos ndikohen po ashtu, në shkallë më të vogël, nga faktorë të tjerë të shumtë siç janë karakteristikat e ndryshme të cilësisë (*vendosja e kohës, ngjyrës, punueshmëria e recetës konkrete, etj.*), kërkesat e konsumatorëve për kategori të veçanta të çimentos, etj.

Mbi këtë bazë, procesi i përcaktimit të çmimeve në (A) bazohet në arsyeshmërinë vijuese:

Çmimet përcaktohen bazuar në vlerësimet e parashikuara vjetore të indikatorëve makroekonomikë të vendit dhe indikatorëve të tjerë të rëndësishëm, siç janë kostoja e naftës dhe burimeve të energjisë, pagave,

inflacionit, kapitalit punues, investimeve kapitale, shpenzimeve të mirëmbajtjes, shpenzimeve të financimit, kosto e kapitalit të angazhuar, shpenzimi fillestar i blerjes, etj.

Çmimet finale për konsumator negociohen dhe pajtohen duke marrë parasysh vëllimin, grupin e klientit, rrezikun dhe garancitë për pagesë të rregullt duke marrë parasysh edhe kushtet mbizotëruese të tregut.

**Kompanitë importuese ofrojnë shërbimin e transportet te klientët**, ndërsa kompania (A) në shumicën e rasteve, shet në baza të *ex-works* në Fabrikën e Çimentos në Han të Elezit dhe blerësit vetë sigurojnë transportin e tyre.(A) po ashtu shet në baza të dorëzimit, dhe ofron shërbime transporti, për blerësit e pjesës perëndimore të Kosovës nëpërmjet dy (2) terminaleve të veta që gjenden në atë zonë.

Shumica e kompanive nuk kanë kompani transportuese, me kamionët e vetë e bartin produktet e çimentos te klienti, kompania (F), për blerjen e çimentos nga Antea Shqipëri ka kontaktuar kompaninë (M) për të kryer transportimin e çimentos. Ndërsa ndërmarrja prodhuese (A) ka angazhuar kompaninë (N) operator logjistik, të cilës ia ka caktuar operimet e dy (2) terminaleve në Klinë dhe Duhle, si dhe aranzhimet relevante të kërkuara për transportin e produkteve të çimentos për blerësit të pjesës perëndimore të Kosovës.

Sa i përket performancës së kompanive nga viti 2018/2019 shumica prej kompanive kishin pasur performancë të mirë, ndërsa prej datës 10.03.2020 deri më 30.06.2020, për shkak të pandemisë Covid-19 qarkullimi i tyre ishte me i ulët rreth 40% krahasuar me vitet paraprake.

Sa i përket shqetësimeve në raport me ndërmarrjet tjera, kompanitë nuk kishin ndonjë shqetësim, ndërsa kompania prodhuese (A) deklaroi se: është përballur me shumë pengesa që nga viti 2010, shumë prej këtyre pengesave lidheshin me qasjen në lëndën e parë dhe pengesat për t'u pajisur me licenca për operimet dhe investimet e veta.

Shpenzimeve operative të kompanive të cilat importojnë çimento nga Shqipëria kanë deklaruar se kanë pasur rritje të shpenzimeve operative si pasojë e taksës rrugore të vendosura nga Shqipëria e cila ka ndodhur që nga viti 2018.

Prodhuesi (.....) ndërmarrja (A) ka pasur rritje të shpenzimeve operative si pasojë e rritjes së inflacionit, çmimi i energjisë elektrike ishte në rritje nga 49.3 euro/MWh sa ishte në vitin 2017 ishte rritur në 57.7 euro/MWh në vitin 2019, kompania kishte pasur investime kapitale nga viti 2010 deri në qershor 2020. Shpenzimet operative dhe investimet kishin rezultuar në rritjen e kostos së prodhimit.

Kompanitë të cilat merren me Blerjen/Importin Prodhimin dhe Shitjen e produktit të çimentos në Kosovë, kishin afaruar me performancë të mirë financiare nga 2018 deri më 10.03.2020, ndërsa nga muaji mars 2020 deri më 30.06.2020, performanca financiare kishte filluar të ulet për shkak të pandemisë Covid-19.

## ***Konkluzion:***

Autoriteti gjatë analizës së tregut të çimentos në Kosovë konsideron se: tregu është i koncentruar në **katër** fabrika prodhuese të (G) të cilat janë: prodhuesi vendor (A) në Kosovë, (I) në (.....),(J) (.....), dhe fabrika (K)në (.....), të cilat e mbulojnë 77.30% të tregut relevant në (.....), kurse pjesa tjetër importohet nga fabrika e (H) nga (.....).

Autoriteti konsideron se: tek tregu me përqendrim të lartë, në të ardhmen nuk përjashtohet mundësia e keqpërdorimit të pozitës dominuese, marrëveshjeve të ndaluara apo praktikave të bashkërenduara, ndërmjet fabrikave prodhuese të çimentos në rajone, andaj **Autoriteti në vazhdimësi do të monitorojë tregun e çimentos në Kosovë.**

Çmimet e çimentos krahasuar me ndërmarrjen prodhuese (A) dhe (.....), për vitet 2018/2019 deri më 30.06.2020, vërehet se **çmimi prodhues ishte më i lartë rreth 3.33%.**

Çmimet e çimentos krahasuar me ndërmarrjen prodhuese (A) dhe (.....) në vitet 2018/2019 deri më 30.06.2020, vërehet se **çmimi prodhues ishte me i ulët rreth 4.00%.**

Konkurrenca në këtë treg është e përqendruar në shumë kompani importuese, të cilat janë përafërsisht 60 kompani. Kompania (A) nuk ka kapacitet t'i mbulojë nevojat e çimentos në Kosovë për faktin se kapaciteti i saj është i limituar, **pasi ajo i mbulon nevojat në tregun e Kosovës rreth 50%.**